

RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 97/2016 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” me anë të këtij projektligji propozohet të shtohet një nen i ri që mbulon fushën e marrdhenieve të Prokurorisë me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Ky nen synon të plotësojë një boshllëk të evidentuar ndër vite në Shqipëri sipas të cilit për veprat penale në fushën e zgjedhjeve ka një terr informacioni nga institucionet shtetërore, ku ceshtjet penale zgjaten me vite në hetim dhe gjykim, dhe publikut nuk i bëhet me dije veprimtaria e institucioneve për hetimin dhe perfundimin e gjykimit apo ekzekutimit të tyre.

Projektligji i propozuar synon të normalizojë këto marrëdhënie, *se pari* në kuadrin e së drejtës së informimit të publikut për hetimin/gjykimin/ekzekutimin e ceshtjeve penale në fushën e zgjedhjeve të cilat padyshim përbejnë interes publik, duke parashikuar që informacioni në lidhje me to duhet të bëhet publik dhe në kohe, dhe *se dyti* transparencën e nevojshme të veprimtarisë së institucioneve duke e mundësuar këto gjë nepermjet shkëmbimit të informacionit të parashikuar në këtë ligj.

Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas juridiksionit përkatës, detyrohen me ligj të japin informacion KQZ-së, brenda 15 ditësh nga kërkesa e kësaj të fundit, për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve. Informacioni jepet me të dhënat për çështjet penale, personat nën hetim, kohëzgjatjen e hetimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, kohëzgjatjen e gjykimit dhe përfundimin e tij, të dhënat për ankimimin e vendimeve gjyqësore, shkakun e ankimimit, si dhe të dhënat për faktin nëse çështjet janë gjykuar në apel ose në Gjykatën e Lartë dhe rezultatin e këtij gjykimi. Pjesë e informacionit duhet të jetë dhe informacioni për ekzekutimin e dënimeve.

Ky informacion sipas këtij ligji do të përdoret nga KQZ-ja për nevojat e informimit publik për gjendjen dhe rezultatet e hetimeve penale për çështjet zgjedhore.

Po ashtu çështja e hetimit të veprave penale në fushën e zgjedhjeve gjithashtu evidentohet si një kompetencë e posaçme edhe për drejtuesin e prokurorisë nëpërmjet shtesës që i bëhet nenit 43 të ligjit, duke rritur kështu mekanizmin e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies në kuadër të hetimit penal të këtyre veprave penale.